



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:263224
Datë: 13.02.2024
Numri i dokumentit: 05323720

ARJ.nr.1/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ragip Namani, kryetar, Nebojša Boričić dhe Rrustem Thaqi, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit A.M, , P..., kundër të paditurit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil i Republikës së Kosovës në P., (KPMSHCK), dhe palën e interesuar Ministria e Tregtisë dhe Industrisë,(MTI) me bazë juridike anulim i vendimit të organit të paditur, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paditësit, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit - Departamenti për Çështje Administrative në P., AA.nr.687/2022 të datës 10.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 09 Shkurt 2024, merr:

A K T G J Y K I M

Refuzohet e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e ushtruar nga paditësi A.M, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit - Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.687/2022 të datës 10.11.2023.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës së Apelit, AA.nr.687/2022 të datës 10.11.2023, është vendosur si në vijim: **REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e paditësit A. M nga P..., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.50/2017, i datës 14.07.2022, **VËRTETOHET**.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit AA.nr.687/2022 të datës 10.11.2023, paditësi në afat ligjor në këtë gjykatë parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale. Propozon të miratohet si e bazuar kërkesa e tij për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, të anulohet Aktgjykimi i Gjykatës së

Apelit AA.nr.687/2022 të datës 10.11.2023, ashtu që Gjykata Supreme të vendos në mënyrë meritorë me vendim përfundimtar, të anulohet regrutimi i shpallur nga MTI , për pozitën Udhëheqës Divizioni për Infrastrukturë dhe Cilësi , të vërtetohet që vendimet e të paditurës i kanë shkaktuar dëme materiale dhe morale paditësit , të vendoset që ankuesi të dëmshpërblehet me paga dhe të ardhura të tjera nga dita kur i përzgjedhuri në mënyrë jo ligjore ka filluar punën dhe të detyrohet e paditura që në afat prej 15 ditë t’ia paguaj shumën e caktuar nga eksperti financiar si kompensim për dëmshpërblim dhe dëmet e sipër cekura.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit nuk ka ushtruar pala e paditur.

Gjykata Supreme, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar, dhe atij të shkallës së parë, sipas kërkesës së paditësit dhe shqyrtimit edhe të akteve tjera të lëndës gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me Vendimin e të paditurit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës në P., (KPMSSHCK) Vendimin A 02/314/2013, të datës 02.09.2013, është vendosur si në vijim: Refuzohet, si e pabazuar ankesa nr. 02/314/2012 e datës 16.08.2013 e parashtruar nga ankuesi A.M, me arsyetimin se në shërbimin civil emërohen kandidatët të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe gojë dhe se kandidati i përzgjedhur ka plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara sipas konkursit.

Kundër vendimit të lartë cekur të KPMSSHCK paditësi me padi fillon konflikt administrativ. Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin, A.nr.50/17, të datës 14.07.2022, në dispozitiv ka vendosur si në vijim: Në pikën I. Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadi e paditësit A.M nga P... me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit 02/314/2013 të datës 02.09.2013, të marrë nga Këshilli i Pavarur për Shërbimin Civil të Kosovës. Në pikën II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj arsyeton ndër të tjera se: Gjykata, duke u bazuar në udhëzimet e Gjykatës së Apelit të përcaktuara me Aktvendimin AA.nr.318/2021 të datës 19.05.2022, në seancën e shqyrtimit kryesor, të mbajtur me datë 13.07.2022, kishte kërkuar nga paditësi që të precizoj saktë palën e paditur dhe aktin administrativ që propozon të anulohet. Pas specifikimit të saktë të palës së paditur nga ana e paditësit, si dhe aktit administrativ që kërkohet të anulohet, gjykata me aktvendim procedural e aprovoi precizimin përkatësisht plotësimin e padisë dhe njëkohësisht, gjithnjë sipas udhëzimeve të Gjykatës më të lartë, i njohu cilësinë e palës së interesuar Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Pas rishqyrtimit të mëtutjeshëm të provave dhe fakteve të prezantuara nga të gjitha palët ndërgjyqëse, gjykata ri konstatoi se nuk ishte kontestuese se paditësi kishte aplikuar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Infrastrukturë të Cilësisë dhe se sikurse pjesëmarrësit tjerë i ishin nënshtruar procedurave konkurruese të jashtme.

Tutje theksohet se: Gjykata gjeti se paditësi nuk e ka bërë të besueshme me asnjë provë të vetme se të njëjtit i është bërë mohim i punësimit, përkundrazi gjeti se paditësit i ishte dhënë mundësia që t'i nënshtrohet procesit të konkurimit sikurse çdo kandidat tjetër, dhe i hodhi poshtë pretendimet në pikëpamje të shkeljes eventuale të të drejtave të tij. Gjykata gjeti se as organi i paditur dhe as Gjykata nuk mund të vlerësoj pretendimin e paditësit se anëtarët e Komisionit i kanë bërë vlerësim jo objektiv për faktin se vlerësimi i tyre është individual dhe vetanak dhe në këtë pikë, ata vlerësojnë sipas bindjes së tyre të lirë. Ndërsa në lidhje me pretendimin e paditësit se është shkelur Rregullorja 02/2010 për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil të Kosovës, gjykata rikonstaton se, me asnjë dispozitë nuk përcaktohet në mënyrë eksplicite obligimi i organit që shpall konkursin që të vendos si kusht diplomën e një lëmie apo tjetrës. Gjykata hodhi poshtë edhe pretendimet e paditësit të dhëna në seancën e shqyrtimit kryesor, me të cilat pohon se: *"ky konkurs është anuluar për shkak se konkursi ka qenë i kurdisur"*. Në lidhje me këto pretendime, gjykata konstatoi se të njëjtat nuk mund të shqyrtohen dhe vlerësohen nga gjykata administrative, por që pretendimet e njëjta, mund të jenë objekt shqyrtimi i gjykatës penale.

Në fund gjykata e shkallës së parë vlerëson se i padituri, ka vepruar në tërësi konform nenit 132 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke shqyrtuar ankesën e paditësit dhe duke vendosur në cilësinë e organit epror, përkatësisht të organit administrativ, vendimi i të cilit paraqet vendim përfundimtar në procedurë administrative. Gjykata po ashtu gjeti se vendimi i kundërshtuar përmban të gjitha elementet e detyrueshme nga neni 47 i LPPA-së, dhe përmban arsyetim të mjaftueshëm dhe të domosdoshëm si parashihet në nenin 48, të po të njëjtit Ligj. Në këtë kuptim, gjykata përfundimisht vlerësoi se vendimi i goditur me padi është i drejtë dhe ligjor bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike.

Gjykata e Apelit me aktgjykimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur sipas ankesës së palës paditëse në kuptim të nenit 49, dhe 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA)-së dhe 194 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK)-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj si më lartë. Në arsyetim pasi bën përshkrimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, bazuar në shkaqet dhe arsyet po ashtu të njëjta, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor, duke vlerësuar se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale me refuzimin e kërkesëpadiisë së paditësit.

Në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë theksohet se: sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se gjykata në arsyetimin e aktgjykimit nuk ka dhënë ndonjë arsyetim lidhur me shkeljen ligjore të bëra me rastin e ndërrimit të anëtarit të komisionit vlerësues z. Sh.H., pa përfillur procedurat ligjore me z. A.S., i cili ligjërisht nuk kishte të drejtë të ishte anëtar i komisionit vlerësues sepse kishte vetëm kontratë pune provuese me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, se gjithashtu gjykata nuk ka dhënë ndonjë arsyetim as lidhur me provën lidhur me Draft Rregulloren e MTI-së e cila specifikon që për pozitën e punës, Udhëheqës i divizionit për infrastrukturë të cilësisë nga kualifikimet për këtë pozitë të punës ndër të tjera kërkohet "Diploma Universitare, Fakulteti Teknik, Ekonomik". Se gjykata sikurse edhe KPMSHCK e ka fshehur dhe injoruar në mënyrë të pa drejtë të mundshme një gjendje faktike lidhur me rekrutimin e parë duke mos e përmendur as me një fjalë të vetme atë që ka ndodhur në rekrutimin e parë në lidhje me punësimin në pozitën e punës Udhëheqës i

Divizionit për Infrastrukturë të Cilësisë. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, ngase konsideron se të njëjtat janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, me që në shkresat e lëndës ekziston vendimi se A.S., është Udhëheqës i Divizionit e jo siç pretendon paditësi që është me kontratë pune provuese, si dhe për faktin se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe gjykata e shkallës së parë, si dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës. Për deri sa paditësi me asnjë provë nuk ka argumentuar vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, ndërsa provat e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike gjykata e shkallës së dytë vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore se aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i pa bazuar dhe i padrejtë, sepse bazohet në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. I dhe 182 par.2 pika n), neni 183 dhe 184 të LPK-së, të cilat aktgjykimin e ankimuar e bëjnë të pa shqyrtueshëm të pa drejtë dhe të pa bazuar për arsye se gjykata në arsyetimin e aktgjykimit nuk ka përfshirë ndonjë sqarim lidhur me pretendimet e paraqitura në padi e as lidhur me provat e paraqitura edhe pse të tillat i kishte administruar si prova në seancën e datës, 13.07.2022. Këto pretendime ankimore ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme për tu aprovuar ankesa, për faktin se gjykata e shkallës së parë në seancën e shqyrtimit kryesor, të mbajtur me datë 13.07.2022, kishte kërkuar nga paditësi që të precizoj saktë palën e paditur dhe aktin administrativ që propozon të anulohet. Pas specifikimit të saktë të palës së paditur nga ana e paditësit, si dhe pas specifikimit të saktë të aktit administrativ që kërkohet të anulohet, gjykata e shkallës së parë me aktvendim procedural, ka aprovuar precizimin përkatësisht plotësimin e padisë dhe njëkohësisht, i ka njohur cilësinë e palës së interesit Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Pas rishqyrtimit të mëtutjeshëm të provave dhe fakteve të prezantuara nga të gjitha palët ndërgjyqëse, gjykata e shkallës së parë me të drejtë rikonstaton se nuk ishte kontestuese se paditësi kishte aplikuar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Infrastrukturë të Cilësisë dhe se sikurse pjesëmarrësit tjerë i ishin nënshtruar procedurave konkurruese të jashtme. Gjykata e shkallës së parë po ashtu gjeti se paditësi i ishte nënshtruar testit me shkrim dhe pastaj intervistimit me gojë dhe se me njoftimin e datës 04.07.2013, ishte përzgjedhur kandidati i suksesshëm. Paditësi i pakënaqur me këtë njoftim, kishte zhvilluar procedurat ankimore në MTI dhe pastaj në KPMSHCK, me ç'rast ky i fundit, e refuzon ankesën e paditësit si të pabazuar. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë gjeti se paditësi nuk e ka bërë të besueshme me asnjë provë të vetme se të njëjtat i është bërë mohim i punësimit, përkundrazi gjeti se paditësit i ishte dhënë mundësia që t'i nënshtrohet procesit të konkurrimit sikurse çdo kandidat tjetër. Duke u bazuar në këto prova, kolegji vlerësoi se aktgjykimi i ankimuar është i drejtë dhe i bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike e juridike. Kolegji i kësaj gjykate vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore të paditësit por të njëjtat i vlerësoi si të pa bazuara, ngase të njëjtat nuk i ka provuar me asnjë provë, në gjykatën e shkallës së parë e as me ankesën e ushtruar në këtë gjykatë.

Prandaj, sipas vlerësimit të kësaj gjykate vendimi i kontestuar i të paditurës dhe aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i nxjerrë në pajtim me dispozitat ligjore të lartë cekura, dhe si i tillë është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të kontestuar, akteve të lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjen se gjykata e shkallës së dytë ka vendosur drejtë me refuzimin si të pabazuar të ankesës së paditësit dhe vërtetimin e aktgjykimit të shkallës së parë. Kjo gjykatë e vlerëson të drejtë qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit, me që aktgjykimi i kontestuar nuk është përfshirë me shkeljet të dispozitave të procedurës kontestimore dhe me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale ashtu si pretendon paditësi në kërkesë.

Aktgjykimet e kontestuara përmbajnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje, nga rezulton se drejtë është vërtetuar gjendja faktike me refuzimin si të pabazuar të kërkesë padisë së paditësit. Bazuar në provat e administruara për mes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve, nga gjykata e shkallës së parë ka rezultuar se vendimi i të paditurit, KPMSHCK, A 02/314/2013, të datës 02.09.2013, me të cilën refuzohet si e pa bazuar ankesa nr.02/314/2012 e datës 16.08.2013, e parashtruar nga ankuesi A.M, me arsyetimin se kandidati tjetër i përzgjedhur i ka plotësuar kriteret e konkursit dhe ka fituar më së shumti pikë, është vendim i drejtë dhe i ligjshëm. Sipas këtij vendimi kandidati i përzgjedhur, për pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit për Infrastrukturë të Cilësisë, Astrit Hasani është ranguar i pari me gjithsej 81.9 pikë, ndërsa ankuesi është ranguar i pesti me 64 pikë.

Gjykata Supreme po ashtu vlerëson se vendimi i të paditurës KPMSHCK është i drejtë dhe i ligjshëm ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate por edhe në bazë të shkresave të lëndës shihet se kandidati i përzgjedhur A.H., i ka plotësuar të gjitha kriteret të përcaktuara sipas konkursit të shpallur me datë 25.04.2013 nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Infrastrukturë të Cilësisë, siç janë: diploma universitare, së paku pesë (5) vjet përvojë pune, të ketë njohuri të mjaftueshme të gjuhës angleze, të njohë MS Office dhe internetin, të ketë aftësi në organizim, komunikim dhe përcaktim të prioritetëve të punëve.

Sipas nenit 2 paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përcaktohet se: *“Merita – veçantia e cila krijon të drejtën e punësimit të një kandidati në një pozitë në shërbimin civil pas përfundimit të suksesshëm të procedurës konkurruese të përzgjedhjes dhe e cila i jep nëpunësit civil të drejtën e avancimit në karrierë, në bazë të rezultateve të dëshmuara gjatë ushtrimit të detyrave administrative”*.

Sipas nenit 40 paragrafi 1 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, përcaktohet se: *“Në shërbimin civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë”*.

Në kuptim të këtyre dispozitave, Gjykata Supreme vlerëson se vendimi i të paditurës është vendim i drejtë dhe i ligjshëm dhe në përputhje me gjendjen faktike të vërtetuar. Komisioni i Rekrutimit, Komisioni për Shqyrtimin e Kontesteve dhe Ankesave, si dhe e paditura

KPMSHCK, kanë zbatuar në tërësi dispozitat nga e drejta materiale në mënyrë adekuate sipas gjendjes faktike të konstatuar në shkresat e lëndës.

Pretendimi i theksuar si në kërkesë, se Gjykata e Apelit ka bërë shkelje të rëndë ligjore me rastin e nxjerrjes së aktgjykimit të datës 10.11.2023, pasi nuk ka respektuar rregulloren nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, saktësisht nenin 10 paragraf 1 pika 1.7, ku përcaktohet se: *“1. Menaxheri i Njesisë së Personelit në institucionin në të cilin do të zhvillohet procedura e rekrutimit kryen një vlerësim të kërkesës së rekrutimit dhe verifikim nëse: 1.7 Aftësitë, shkollimi dhe kualifikimet tjera të kërkuara janë në përputhje me natyrën e vendit të punës”*, kolegji i kësaj gjykate njëjtë sikurse edhe gjykatat e instancave më të ulëta e vlerëson në tërësi si të pabazuar dhe të paqëndrueshëm, ngase kjo dispozitë ligjore nuk ka përcaktuar detyrimin e organit të administratës që për pozitën e lirë të punës, të përcaktoj drejtimin specifik, madje se cili drejtim kërkohet për një pozitë apo vend pune nuk është përcaktuar me asnjë nga dispozitat e kësaj rregulloreje mirëpo siç theksohet edhe në këtë dispozitë mbetet në kompetencën e menaxherit të njesisë së personelit të vlerësoj se cilat aftësi, cili nivel i shkollimit dhe kualifikim i kandidatit është në përputhje me natyrën e vendit apo pozitës së punës.

Ndërsa lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës ku thekson; se ka pas rregullore MTI-ja në të cilat rregullore për secilën pozitë të punës specifikohet lloji ose llojet e drejtimeve universitare e në rastin konkret kjo draft rregullore e MTI-së specifikon që për këtë pozitë të punës kërkohet: *“Diploma universitare, Fakulteti Teknik, Ekonomik”*, kolegji po ashtu i vlerëson si të paqëndrueshme dhe të pabazuara sepse i njëjti nuk specifikon se cila ka qenë kjo rregullore, kur është nxjerrë apo kur ka hyrë në fuqi, dhe me cilat dispozita ligjore është përcaktuar ky kriter, dhe për më tepër paditësi kësaj rregulloreje i referohet me termin draft rregullore, e cila nuk ka fuqi juridike përderisa të aprovet/nënshkruhet nga autoriteti kompetent/.

Në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës përtej referimit në nenet e lartcekura të Rregullores nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, dhe përmbajtjen e tyre dhe përtej formulimit të pretendimeve të përgjithësuara, nuk ka arsyetuar në mënyrë të qartë dhe adekuate se si mund të jenë cenuar apo shkelur këto nene përmes aktgjykimit të kontestuar. Prandaj, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të dispozitave ligjore sipas neneve të theksuar si në kërkesë, janë pretendime të pambështetura dhe të paarsyetuara. Në kontekst të këtyre pretendimeve, gjykata duke u bazuar në dispozitat e lartcekura dhe shkresat e lëndës, vlerëson se paditësi ka dështuar që të qartësojnë saktësisht dhe në mënyrë adekuate faktet dhe pretendimet e tij dhe gjithashtu të dëshmojnë dhe të mbështes me prova pretendimet për shkelje të dispozitave ligjore procedurale apo zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Ndërsa lidhur me thëniet e parashtruesit të kërkesës se nëse edhe Gjykata Supreme nuk e interpreton dhe nuk e konstaton drejtë këtë rast, këtë çështje do ta bëjë publike në media të ndryshme me ndihmën e organizatave jo qeveritare që merren me sundimin e ligjit dhe pastaj publiku ta vlerëson këtë rast, kjo gjykate thekson se, të njëjtat nuk kanë ndonjë ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje ngase gjyqtari gjatë ushtrimit të funksionit të tij i përmbahet ligjit dhe kodit të etikës, është i pavarur në raport me pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv, publikun, mediumet, dhe institucionet e tjera si dhe në raport me palët në procedurë dhe nuk i

nënshtrohet apo vet nënshtrohet asnjë presioni eventual, se gjyqtari gjatë ushtrimit të funksionit të tij është i pavarur në aspektin e marrjes së vendimit duke vendosur drejtësisht dhe me kompetencë në çështjet konkrete dhe çdo rast të ngritur, bazuar në prova dhe ligj.

Gjykata i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës, por gjen se të njëjtat janë shqyrtuar nga gjykatat e instancave më të ulëta, dhe me të drejtë janë refuzuar si të pa bazuara dhe jo të qëndrueshme ligjërisht, andaj nuk janë me ndikim për vendosjen ndryshe në këtë çështje nga çka kanë vendosur gjykatat e instancave më të ulëta. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate gjykatat e instancave më të ulëta kanë vepruar në baza ligjore me vendosjen e çështjes në mënyrë meritore, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, i vërtetuar në procedurë ankimore nga gjykata e shkallës së dytë. Aktgjykimi i kontestuar i gjykatës së shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm dhe sipas gjendjes faktike të vërtetuar edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, andaj nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit.

Nga theksimet si më lartë, e në bazë të nenit 54 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË
ARJ.nr.1/2024, më datë 09 Shkurt 2024

B. Profesionale,
Zanë Buçinca

Kryetari i Kolegjit,
Ragip Namani